

20194

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT TIRANE  
Nr. 20.194 VENDIMIT

## V E N D I M

### PER REGJISTRIMIN NE REGJISTRIN TREGETAR TE SHOQERISE "ALFLEXIM" Shpk.

Sot me date 26.10.1998, une gjyqtari.....*Arbila Copo*.....pasi studiova materialet e paraqitura nga Fatos Ahmataj, me cilesine e Administratorit te Shoqerise "ALFLEXIM" Shpk,

#### KONSTATOVA SE:

Me vullnetin e lire te ortakeve Fatos Ahmataj dhe Agron Bejta eshte themeluar nje Shoqeri tregtare me pergjegjisi te kufizuar, te cilen e kane emertuar "ALFLEXIM" Shpk. Kjo Shoqeri ka nje kapital themelor prej 100.000 lekesh, te depozituara ne Banken e Tiranes Sh.A. Ajo ka seline e saje legale dhe administrative ne Tirane ne adresen: Rruga "Myslym Shyri" P.60/4, dhe do te zhvilloje aktivitetin e saje ne fushat e Import-Eksportit te mallrave ushqimore dhe industriale, paisjeve fotokopjuse dhe pjeseve te tyre, paisjeve te parapergatitjes per shtyp dhe pisjeve te tjera ndihmese te tyre. Te organizoje dhe kryej sherbime fotokopjimi dhe parapergatitjeje per shtyp si art design, lay-out, si dhe te kryeje investime ne fushat e mesiperme. Shoqeria do te veproje deri ne Maj 2003. Sa me siper jane pasqyruar ne Aktin e Themelimit dhe Statutin perkates te Shoqerise, te nenshkruara nga ortaket dhe te vertetuara nga noteri. Dokumentacioni i hartuar per krijimin e Shoqerise eshte ne perputhje me ligjin prandaj dhe duhet miratuar.

#### PER KETO ARSYE

Ne mbeshtetje te Ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 dhe Ligjit 7667, date 28.01.1993

#### V E N D O S A :

- 1.- Te urdheroj regjistrimin e Shoqerise "ALFLEXIM" Shpk ne Regjistrin Tregetar me ortake Fatos Ahmataj dhe Agron Bejta, si dhe depozitimimin e akteve te kesaj Shoqerie: Kontrate Themelimi date 25.09.1998, Statut i po kesaj date, kerkesa e Administratorit date 9.10.1998 dhe mandati i Bankes se Tiranes Sh.A date 23.09.1998.
- 2.- Shoqeria e ka seline e saje ligjore ne Tirane, Rruga "Myslym Shyri", P.60/4.
- 3.- Kapitali themelor i Shoqerise eshte 100.000 leke, ndare ne 100 kuota nga 1.000 leke secila.
- 4.- Administrator i pare i Shoqerise eshte Fatos Ahmataj.
- 5.- Objekti i veprimtarise ekonomike te Shoqerise do te jete:  
Import-Eksport I mallrave ushqimore dhe industriale, paisjeve fotokopjuse dhe pjeseve te tyre , paisjeve te parapergatitjes per shtyp dhe paisjeve te tjera ndihmese te tyre. Te organizoje dhe kryej sherbime fotokopjimi dhe parapergatitjeje per shtyp si art design, lay-out, dhe te kryej investime ne fushat a mesiperme.
- 6.- Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne Gjykatën e Apelit.

Tirane, me 26.10.1998

GJYQTARE

*Arbila Copo*  
*Cop*  
*S*

4238

**V E N D I M**  
**I Gjyqtarit Te Vetem**

Sot me dt. 26/10/ 1999 une gjyqtarja e gjykates se rrethit Tirane mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga administratori Fatos Ahmataj i shoqerise ALFLEXIM sh.p.k. per pasqyrimin ne regjistrin tregtar te ndryshimeve ne statutin e shoqerise.

**K O N S T A T O V A**

Shoqeria ALFLEXIM sh.p.k. eshte person juridik i regjistruar ne regjistrin tregtar me vendimin e kesaj gjykate nr.20194 dt.26.10.1998.

Shoqeria eshte regjistruar ne pronesi te dy ortakeve te saj Fatos Ahmataj dhe Agron Bejtja duke zoteruar secili nga 50% te kuotave te kapitalit.

Me kerkesen e ortakut Agron Bejtja, asambleja e ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore per shoqerite tregtare, ka miratuar shitjen e kuotave te kapitalit themeltar te ortakut Agron Bejtja dhe blerjen e tyre nga ortaku Fatos Ahmataj, per kete asambleja e ortakeve ka marre vendimin nr. 5 dt. 30.09.1999.

Ortaket kane lidhur me pas, perpara noterit kontraten e shitjes se kuotave te kapitalit, e cila mban nr.1398 kol dhe nr.237 prot. Date 06.10.1999. Me lidhjen e kesaj kontrate dhe ne baze te vendimit te asamblese se ortakeve, ortaku Fatos Ahmataj behet zoterues i 100% te kuotave te kapitalit te shoqerise ALFLEXIM sh.p.k. dhe rrjedhimisht ortak i vetem i saj.

Per arsyet e mesiperme kerkohet nga gjykata qe te pasqyrohen keto ndryshime ne regjistrin tregtar.

Gjykata pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe e konsideroi ne perputhje me ligjin eshte e mendimit te pranoje kerkesen e paraqitur nga administratori i shoqerise ALFLEXIM sh.p.k.

**P E R K E T O A R S Y E**

Ne baze te ligjit nr. 7638 dt. 19. 11.1992 Per shoqerite tregtare si dhe te ligjit nr.7667 dt. 28.01.1993 Per regjistrin tregtar

**V E N D O S I**

Pranimin e kerkeses.

Depozitimim ne regjistrin tregtar te vendimit nr.5 dt. 30.09.1999 te asamblese se ortakeve te shoqerise ALFLEXIM sh.p.k. dhe te kontrates se shitjes se kuotave te kapitalit nga ortaku Agron Bejtja per llogari te ortakut Fatos Ahmataj.

Te behen ndryshimet perkatese ne regjistrin tregtar.

Kunder vendimit lejohet ankim.

Gjyqtare

Arull Cepo  
Oly

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE  
NR. 20194/2

V E N D I M  
I GJYQTARIT TE VETEM

Sot, me date 30.09.2003 une gjyqtarja e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Fatos Ahmataj kerkon depozitim e vendimit nr.1, date 20.09.2003 te Ortakut te Vetem te shoqerise ALFLEXIM SHPK dhe;

KONSTATOVA SE :

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "ALFLEXIM" SHPK eshte regjistruar si person juridik me vendimin nr. 20194, date 26.10.1998, me ortak Agron Bejta dhe Fatos Ahmataj, me administrator Fatos Ahmataj, me seli ne Tirane, me kapital 100.000 leke.

Me vendimin nr.20194/1, date 26.10.1999, te Gjykates se Rrethit Tirane eshte vendosur largimi i ortakut Agron Bejtja dhe shitja e kuotave te kapitalit qe zoteronte ai tek z. Fatos Ahmataj. Perfundimisht shoqeria ALFLEXIM SHPK mbetet me ortak e administrator te vetem Fatos Ahmataj.

Me vendimin e Ortakut te Vetem nr.2, date 20.09.2003, eshte vendosur te shtohet objekti i veprimtarise se shoqerise edhe ;

"Import Export i mallrave ushqimore dhe industriale, makinerive, pajisjeve dhe linjave teknologjike.

Te instaloje: sisteme sigurimi dhe alarmi, sisteme kontrolli te hyrje-daljeve, sisteme vrojtimi (CCTV) dhe regjistrimi me figure dhe zanore, sisteme transmetimi ne distance te dhenave, rrjete informatike si dhe te prodhoje te instaloje dhe tregtoje programe kompjuterike qe lidhen me veprimtarite e mesiperme.

Te instaloje : sisteme per personalizimin e kartave te identifikimit dhe kartave bankare. Te kryeje sherbime per personalizimin e kartave si dhe investime per implementimin e projekteve ne subjekte te tjera private dhe shteterore te ketyre sistemeve.

Te tregtoje dhe instaloje makina fotokopjimi dhe riprodhimi si dhe pjeset e tyre, pajisje te parapergatitjes per shtyp ne film dhe laster dhe pjeset

e tyre si dhe te organizoje dhe kryej sherbime fotokopjimi dhe te parapergatitjes per shtyp.

Te realizoje dhe tregtoje publikime ne forme te shkruar ose nepermjet mjeteve elektronike si : revista, broshura, libra, manuale te specializuar etj.

Afati i veprimtarise se shoqerise do te behet deri ne vitin 2030.

Shoqeria "ALFLEXIM shpk do te administrohet nga ortaku i Vetem Fatos Ahmataj, i biri i Hakiut, i datelindjes 1950, lindur dhe banues ne Tirane, rruga "Sami Frasheri", pall.13/1, shk.1, ap.5

Per sa me siper, nga dokumentat e paraqitura rezulton se kerkesa eshte ne perputhje me kushtet e parashikuara nga ligji dhe si e tille duhet pranuar.

**PER KETO ARSYE :**

Ne baze te ligjit 7667 , date 19.11.1992 " Per regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhet te plotesohen ne te",

**V E N D O S A :**

Pranimin e kerkeses per depozitimimin e vendimit nr.2, date 20.09.2003 te Ortakut te Vetem te shoqerise "ALFLEXIM" SHPK, per shtesen e objektit te sipershenuar .

Te behen shenimet perkatase ne regjistrin tregtar, ne kollonen nr.2, germa "c" dhe ne kollonat 4,5 duke u ndare regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

**G J Y Q T A R E  
A N I L A C A P O**



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR**  
**TIRANE**

NR. 20 184/3 Vendimi

**VENDIM**  
**I GJYQTARIT TE VETEM**

NE Tirane, sot me dt. 30.12.2005, une Mariana DEDI, Gjyqtare e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, morra ne shqyrtim kerkesen dhe materialet e paraqitura nga kerkuesi FATOS AHMATAJ, i cili kerkon depozitimim e Vendimit Nr.1 te dt. 18.06.2005 te Oratkut te Vetem te Shoqerise "ALFLEMIX" Sh.p.k dhe

**KONSTATOVA SE:**

Me vendimin Nr.4398 date 17.05.1993 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, Shoqeria "ALFLEMIX" Sh.p.k eshte rregjistruar si person juridik me seli ne Tirane per te ushtruar aktivitetin e vet privat sipas objektit te veprimtarise se vendosur ne statusin e shoqerise.

Me Vendimin e Ortakut te Vetem te Shoqerise Nr.1, dt. 18.06.2005 eshte vendosur:

1. Te fillojne procedurat per zmadhimin e kapitalit te shoqerise duket bere vleresimin sipas kerkesave ligjore, kerkese konform nenit 42 te ligjit 7638 dt. 19.11.1992 "Per shoqerite Tregtare".
2. Per efekt te zmadhimit te kapitaleve te Shoqerise ngarkohet ligjerisht te shprehet per kete qellim Zoti Naim Malo, ekspert kontabel i autorizuar me license Nr. 134.

Kerkesa e paraqitur eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

**PER KETO ARSYE**

Ne baze te ligjit 7638, date 19.11.1992 dhe 7667 date 28.01.1993

**VENDOSA**


Pranimin e kerkeses.

Depozitimim e Vendimit Nr.1, te dates 18.06.2005 te Ortakut te Vetem te Shoqerise "ALFLEXIM" Sh.p.k ne te cilin eshte vendosur:

1. Te fillojne procedurat per zmadhimin e kapitalit te shoqerise duket bere vleresimin sipas kerkesave ligjore, kerkese konform nenit 42 te ligjit 7638 dt. 19.11.1992 "Per shoqerite Tregtare".
2. Per efekt te zmadhimit te kapitaleve te Shoqerise ngarkohet ligjerisht te shprehet per kete qellim Zoti Naim MALO, ekspert kontabel i autorizuar me license Nr. 134.
3. Urdherimin e Zyres se Regjistrimit per te bere depozitimim e vendimit sa siper dhe berjen e ndryshimeve perkatese ne regjister.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim

**GJYQTARE**  
**MARIANA DEDI**



**V E N D I M**  
**I GJYOTARIT TË VETËM**

Në Tiranë, sot më datën 18.05 2006, unë D. Malo, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë mora në shqyrtim kërkesën dhe materialet e paraqitura nga kërkuesi FATOS AHMATAJ, në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë, i cili kërkoj depozitimin e vendimit Nr.2 të datës 1.2.2006 të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë "ALFLEXIM" Sh.p.k., dhe

**KONSTATOVA SE**

Me vendim nr. 4398 date 17.5.1993, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Shoqëria "ALFLEXIM" Sh.p.k. është regjistruar si person juridik me seli në Tiranë për të ushtruar aktivitetin e vet privat sipas objektit të veprimtarisë së vendosur në statutin e shoqërisë.

Me vendimi nr. 20194/3 datë 31.12.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është pranuar fillimi i procedurave për rritje të kapitalit të shoqërisë, duke u miratuar si ekspert kontabel i autorizuar zoti Naim Malo.

Me vendimi nr. 2 datë 01.02.2006 të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë është vendosur:

1. Te pranojë aktin e ekspertimit të kryer nga eksperti kontabel i miratuar, i ngarkuar për të bërë vlerësimin e kapitalit në rritje të shoqërisë Alfexim, nëpërmjet fitimit të mbartur dhe fitimit të ushtrimit, me vlerë perfundimtare 12.879.683 lek.
2. Ngarkohet Administratori i Shoqërisë të kërkojë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, depozitimin e vendimit të ortakut të vetëm nr 2 date 1.2.2006, pranë Zyrës së Regjistrimit Tregtar për pasqyrimin e ndryshimit të sipërme në dokumentacionin e shoqërisë "ALFLEXIM" shpk, së bashku me aktin e ekspertimit të ekspertit Zotit Naim Malo.

Kërkesa e paraqitur është e drejtë dhe si e tillë duhet pranuar.

**PËR KËTO ARËSYE:**

Në bazë të Ligjit 7638 dt. 19. 11. 1992 dhe 7667 dt. 28. 01. 1993.

**VENDOSA**


- I. Pranimin e kërkesës.
- II. Depozitimin e Vendimit Nr. 2 të datës 01.02.2006 të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "ALFLEXIM" Sh.p.k. në të cilin është vendosur:

1. Te pranoje aktin e ekspertimit te kryer nga eksperti kontabel i miratuar, i ngarkuar per te bere vleresimin e kapitalit ne rritje te shoqerise Alflexim, nepermjet fitimit te mbartur dhe fitimit te ushtrimit, me vlere perfundimtare 12. 879.683 lek.
2. Ngarkohet Administratori i Shoqërisë te kërkojë prane Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, depozitimn e vendimit te ortakut te vetem nr 2 date 1.2.2006, prane Zyrës se Regjistrit Tregtar për pasqyrimin e ndryshimit te siperm ne dokumentacionin e shoqerise "ALFLEXIM" shpk, se bashku me aktin e ekspertimit te ekspertit Zotit Naim Malo.

III. Ndryshimi i nenit te akt-themelimit dhe statutit ku eshte percaktuar kapitali i shoqerise me vleren 12. 879.683 lek, e cila perfaqeson kapitalin e ri te kesaj shoqerie.

IV. Urdhërimin e Zyrës së Regjistrit për bërjen e ndryshimeve përkatëse në regjistër.

Kundër këtij vendimi lejohet ankim.

GJYQTARE  


REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE  
Nr. 20194/5 vendimit

V E N D I M  
I G J Y Q T A R I T T E V E T E M

Sot me daten 05/12/2006 Une Gjyqtare e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane Blerina Muca, pasi shqyrtova dokumentet e paraqitura nga shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "ALFLEXIM" shpk me Administrator Te Pergjithshem: Z. Fatos Ahmataj me banim ne Tirane ,madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, per depozitimin e dokumentave ne shoqeri,

V E R E J :

Me vendim te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane nr. 20194 date 26.10.1998 eshte themeluar shoqeria "ALFLEXIM" shpk me objekt te percaktuar me hollesisht ne vendimin e saj.

Duke u mbeshtetur ne Ligjin 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" ortakut i vetem i shoqerise me vendimin Nr.4 date 25.6.2006 ka vendosur :

1-Korigjimin ne vendimin e gjykates nr.20194/3 date 30.12.2005 dhe te vendimit te gjykates nr.20194/4 date 18.5.2006 te numrit te regjistrimit te shoqerise dhe te emerit te saj nga nr.4398 date 17.05.1993 ne nr.20194 date 26.10.1998 dhe emerit nga "ALFLEMIX" ne "ALFLEXIM" Shpk.

2-Zmadhimin e kapitalit te shoqerise duke caktuar ekspertin kontabel te autorizuar Z.Naim Malo per te realizuar raportin e ekspertimit per zmadhimin e kapitalit te shoqerise per vitin ushtrimor 2005.

\*Depozitimin e kerkeses prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Nga dokumentet e paraqitura rezulton se kerkesa eshte e drejte dhe e bazuar ne Ligj dhe si e tille te pranohet.

P E R K E T O A R S Y E

Ne mbeshtetje te Ligjit Nr.7667 date 28 janar 1993 dhe Ligjit Nr.7638 dt.19.11.1992

V E N D O S A

\*Pranimin e kerkeses.

\*Depozitimin e kerkeses, vendimit te ortakut te vetem Nr.4 dt.25.6.2006, te paraqitura nga shoqeria "ALFLEXIM" shpk duke u bere shenimet perkatese ne fleten e regjistrimit ne kollonen 4 e kollona 5, te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

G J Y Q T A R E  
BLERINA MUÇA





REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE  
Nr 20194/6 vendimit

V E N D I M  
I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me daten 25/01/2007 Une Gjyqtare e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane Blerina Muca, pasi shqyrtova dokumentet e paraqitura nga shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "ALFLEXIM" shpk me Administrator Te Pergjithshem: Z. Fatos Ahmataj me banim ne Tirane ,madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, per depozitimin e dokumentave ne shoqeri,

V E R E J :

Me vendim te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane nr. 20194 date 26.10.1998 eshte themeluar shoqeria "ALFLEXIM" shpk me objekt te percaktuar me hollesisht ne vendimin e saj.

Duke u mbeshtetur ne Ligjin 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" ortaku i vetem i shoqerise me vendimin Nr.6 date 20.12.2006 ka vendosur :

**1-Miratimin e raportit te ekspertit kontabel per zmadhimin e kapitalit te shoqerise.**

**2-Miratimin e shteses se kapitalit te shoqerise edhe me 4.835.395 leke.**

\*Depozitimin e kerkeses prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Nga dokumentet e paraqitura rezulton se kerkesa eshte e drejte dhe e bazuar ne Ligj dhe si e tille te pranohet.

PER KETO ARSYE


Ne mbeshtetje te Ligjit Nr.7667 date 28 janar 1993 dhe Ligjit Nr.7638 dt.19.11.1992

V E N D O S A

\*Pranimin e kerkeses.

\*Depozitimin e kerkeses, vendimit te ortakut te vetem Nr.6 dt.20.12.2006, raportit te ekspertit te paraqitura nga shoqeria "ALFLEXIM" shpk duke u bere shenimet perkatese ne fleten e regjistrimit ne kollonen 4 e kollona 5, te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.


G J Y Q T A R E  
BLERINA MUCA





# K O N T R A T E

## PER THEMELIMIN E SHOQERISE "ALFLEXIM" Shpk.



Lidhur sot me date 25.09.1998 ne Tirane, midis partnereve te meposhtem:

- 1.-Z.Fatos Haki AHMATAJ, lindur ne Tirane me 02.03.1950, me kombesi dhe shtetesi shqiptare, me pasaporte nr.0719973, banues ne rrugen "Sami Frasheri" Nr.13/1 Tirane.
- 2.-Z. Agron Eshref BEJTA, lindur ne Tirane me 19.12.1956, me kombesi dhe shtetesi shqiptare, me pasaporte nr.0863354, banues ne rrugen "Mihal Grameno" P12/42 Tirane

te cilet me vullnetin e tyre te lire, ne mbeshtetje te Nenit 1 te Ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 bien ne marrveshje per sa me poshte:

### Neni 1

Te themelojne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar te quajtur "ALFLEXIM" Shpk. Kjo shoqeri eshte person juridik Shqiptar, i cili fiton zotesi Juridike qe nga momenti i regjistrimit ne "Regjistrin e Shoqerive Tregtare" ne Tirane.

### Neni 2

Selia e Shoqerise do te jete ne adresen: Rruga "Myslym Shyri" Nr.60/4.

### Neni 3

Kapitali fillestar i Shoqerise eshte vendosur 100.000 leke dhe eshte derdhur prane Bankes Tiranes Sh.A me Nr. Llogarie 001736.01.Ai perbehet nga 100 pjese me vlere 1,000 leke secili, paguar nga partneret ne masen e meposhteme:

1.-Fatos Ahmataj	50.000 leke (50%)
2.-Agron Bejta	50.000 leke (50%)

Çdo pjese ka te drejten e nje vote ne Asamblene e Ortakeve.

### Neni 4

Shoqeria do te kryej ne territorin e Shqiperise dhe gjithkund ku te munde njerin apo te gjithë aktivitetet e meposhtem:

Import-Eksport i mallrave ushqimore dhe indusatriale, paisjeve fotokopjuse dhe pjeseve te tyre, paisjeve te parapergatitjes per shtyp dhe paisjeve te tjera ndihmese te tyre. Te organizoje dhe kryej sherbime fotokopjimi dhe parapergatitjeje per shtyp si art design, layout, dhe te kryej investimeve ne fushat e mesiperme.



### **Neni 5**

Periudha e ushtrimit te aktivitetit te Shoqerise perfundon ne Maj 2003.

### **Neni 6**

Organet pergjegjes te Shoqerise, qe do te pergjigjen perpara ligjit per drejtimin e saj do te jene:

- 1.-Asambleje e Ortakeve
- 2.-Administratori i Shoqerise

Partneret bien ne marrveshje qe administrator i Shoqerise te jete Z.Fatos Ahmataj me mandat nje vjeçar dhe me te drejte rizgjedhje.

Rregullat e tjera te administrimit te Shoqerise jane parashikuar ne Statutin e Shoqerise bashkelidhur kesaj kontrate.

### **Neni 7**

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor te çdo viti.

Asnje transferim kapitali nuk mund te kryhet pa miratimin me shkrim te te dy partnereve.

### **Neni 8**

Te gjitha mosmarrveshjet midis partnereve do te zgjidhen me mirekuptim, ne te kundert ata do ti drejtohen Gjykates se Tiranes, vendimi i se ciles eshte i detyrueshem per te dy palet.

### **Neni 9**


Kjo kontrate, hartuar ne gjashte kopje identike u nenshkrua rregullisht nga te dy partneret sot me date 25.09.1998

## **P A R T N E R E T**

**Fatos AHMATAJ**

**Agron BEJTA**

# STATUT



## I SHOQERISE TREGETARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "ALFLEXIM" Shpk.

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "ALFLEXIM" Shpk formohet nga partneret: Fatos Ahmataj dhe Agron Bejta, te cilet me vullnetin e tyre te lire kane hartuar dhe miratuar kete Statut me nenet e meposhtem:

### KAPITULLI I *forma legale*

#### Neni 1

Shoqeria "ALFLEXIM" Shpk, e cila me poshte do te quhet "Shoqeria", themelohet ne perputhje me Aktin e Themelimit perpiluar dhe firmosur nga partneret sipas Ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992 "Mbi Shoqerite Tregtare" dhe Kodin Civil si dhe me Ligjet e tjera ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

#### Neni 2 *statusi juridik*

Statusi juridik i Shoqerise eshte "SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR", prandaj parneret do te marrin pjese ne fitim dhe mbajne pergjegjesi per ecurine e llogarive te Shoqerise ne ate mase sa eshte edhe kontributi i tyre ne kapitalin themelor te Shoqerise.

### KAPITULLI II *emri, selia dhe afati*

#### Neni 3 *emertimi*

Emertimi tregetar i Shoqerise eshte "ALFLEXIM" Shpk.

#### Neni 4 *selia*

Selia e Shoqerise do te jete ne Rrugen "Myslym Shyri" P.60/4 Tirane. Shoqeria mund te hape dege dhe agjensi te saja brenda dhe jashte Tiranes si edhe jashte teritorit te Shqiperise ne perputhje me vendimin e Asamblese se Ortakeve.



**Neni 5**  
*afati*

Afati i ushtrimit te aktivitetit te Shoqerise do te perfundoje ne Maj 2003.

**KAPITULLI III**  
*objekti*

**Neni 6**

Objekti i aktivitetit te Shoqerise do te jete:

Import-Eksport i mallrave ushqimore dhe industriale, paisjeve fotokopjuse dhe pjeseve te tyre, paisjeve te parapergatitjes per shtyp dhe paisjeve te tjera ndihmese te tyre. Te organizoje dhe kryej sherbime fotokopjimi dhe parapergatitjeje per shtyp si art design, layout dhe te kryej investime ne fushat e mesiperme.

**KAPITULLI IV**  
*kapitali themelor i Shoqerise*

**Neni 7**  
*kapitali i Shoqerise*

Kapitali themelor i Shoqerise eshte ne masen 100.000 leke, i cili eshte paguar teresisht nga partneret prane llogarise rrjedhese ne Banken e Tiranës Sh.A Nr. 001736.01. Ai perbehet nga 100 pjese te barabarta me vlere prej 1.000 leke (sipas ligjit 7638/1992 art.38/2) Partneret leshojne siguri per nje vlere te kontributeve te tyre te ndare si me poshte:

- |                  |                                   |
|------------------|-----------------------------------|
| a) Fatos Ahmataj | 50.000 leke, ose 50% te aksioneve |
| b) Agron Bejta   | 50.000 leke, ose 50% te aksioneve |

**Neni 8**  
*transferimi i kapitaleve*

Menyra e transferimit te kapitaleve mund te jete ajo e zakonshme ose ne çfardo forme tjeter te cilen e miraton Asambleja e Ortakeve dhe qe ekzekutohet nga ose ne favor te transferuasit.

**KAPITULLI V**  
*organizimi i Shoqerise*

**Neni 9**  
*organet drejtuse*

Organet drejtuse te Shoqerise jane:

- 1.-Asambleja e Ortakeve
- 2.-Administratori

**Neni 10**  
*mbledhja e pergjitheshme*

Mbledhja e Pergjitheshme e Ortakeve eshte autoriteti me i larte i Shoqerise. Kompetencat e tije jane ato qe parashikon Ligji dhe keto nene te Statutit.

Te gjitha mbledhjet e tjera ndryshe nga Mbledhja e Pergjitheshme Vjetore quhen Mbledhje te Jashtezakonshme.

Administratori sa here qe e gjykon dhe ne perputhje me Kontrarten e Statutin proçedon me Mbledhjen e Jashtezakonshme.

Mbledhja e Pergjitheshme e thirret per miratimin e raportit te paraqitur nga Administratori per bilancin vjetor dhe rezultatet financiare. Kjo organizohet çdo vit brenda tre muajsh nga dita e perfundimit te vitit financiar.

**Neni 11**

Mbledhja e Pergjitheshme e Asamblese kryesohet nga Administratori ose çdo person i autorizuar prej tije.

**KAPITULLI VI**  
*administrimi*

**Neni 12**

Shoqeria administrohet nga Administratori.

**Neni 13**  
*kompetencat dhe pergjegjesite*

Drejtuesi i Shoqerise ka te gjitha kompetencat per administrimin e saja, te kryeje veprime ne emer te Shoqerise me te tretet ne çdo suate, perveç atyre qe parashikohet te deçizohen nga partneret. Drejtusi ka te gjitha fuqite dhe te drejtat ta perfaqesoje Shoqerine perballe personave te trete fizike dhe juridike shteteror ose privat, ta perfaqesoje perpara gjyqit te çdo niveli, te emeroje eksperte te fushave te ndryshme per mbrojtjen e interesave te Shoqerise.

**Neni 13**

Mbledhja e pergjitheshme percakton pagat fikse mujore dhe shperblimet suplementare te punonjesve, te cilat mund te ndryshoje me vone vetem me vendim te saja.

**KAPITULLI VII**  
*llogarite*

**Neni 14**

Aktiviteti ekonomik i Shoqerise perfundon me 31 Dhjetor te çdo viti.

### Neni 15

Ne fund te çdo viti financiar, brenda tre muajsh Administratori se bashku me financierin pergatit bilancet financiare te cilat japin nje pasqyre te vertete te gjendjes se Shoqerise per vitin perkates financiar si dhe gjendjen e pronesise e bilancin ekonomik.

### Neni 16

Ne perputhje me nenin 213 te Ligjit 7638 date 19.11.1992 duhet te parashikohet nje fond jo me pak se 5% qe do te perdoret si fond rezerve, i quajtur fond i veçante, i cili nuk mund te jete me shume se 10% te kapitalit fillestar.

## KAPITULLI VII

*mbarimi i veprimtarise dhe likujdimi*

### Neni 17

*mbarimi i veprimtarise*

Shoqeria mund te perfundoje veprimtarine me Vendim te Mbledhjes se Pergjitheshme. Arsyet e mbarimit te veprimtarise jane.

- a) perfundimi i periudhes se kohezgjatjes se Shoqerise
- b) ne rastet kur Asambleja e Ortakeve vendos per nje gje te tille
- c) ne rastet e tjera te parashikuara nga Ligji 7638/1992.

### Neni 18

*likujdimi*

Mbyllja e aktivitetit te Shoqerise ne çdo rast sjell likujdimin e Shoqerise. Proçedurat e likujdimit aplikohen ne perputhje me Ligjin 7638/1992.

### Neni 19

*Terma te fundit*


Per çdo gje qe nuk eshte parashikuar ne kete Statut do te zbatohen ligjet ne fuqi, veçmas Ligji Nr.7638, date 19.11.1992 per "Shoqerite Tregtare" dhe Kodi Civil.

### Neni 20

Te gjitha mosmarrveshjet midis partnereve do tentohet te zgjidhen me mirekuptim, ne te kundert palet do ti drejtohen per zgjidhjen e tyre Gjykates se Tiranes.

## PARTNERET

Fatos AHMATAJ



Agron BEJTA







*Handwritten notes and signatures in the top right corner, including a circular stamp from Tirane.*

**K E R K E S E  
GJYKATES SE RRETHIT  
T I R A N E**

**KERKUESI:** Shoqeria "ALFLEXIM" shpk, perfaqsuar nga Administratori i saj z. Fatos Ahmataj.  
**BJEKTI:** Regjistrimi i shoqerise tregtare "Alflexin" shpk ne regjistrin tregtar si person juridik.

**ZOTI GJYQTAR**

Ne daten 25.09.1998 eshte themeluar shoqeria "ALFLEXIM" shpk nga ortaket Fatos Ahmataj dhe Agron Bejta .  
Kjo shoqeri do te zhvilloje veprimtarine e vet ekonomike ne territorin e Shqiperise dhe do te importoje dhe eksportoje mallra te ndryshme, makineri e paisje per pergatitje per shtyp dhe paisje shtypi, do te kryeje sherbime ne fushen e parapergatitjes per shtyp dhe te shtypit, si dhe aktivitete ne fushen e investimeve ne sektore te ndryshem. Selia e shoqerise do te jete ne Tirane, rruga "Myslym Syri" pallati 60/4 dhe administrator i pare i shoqerise do te jete z. Fatos Ahmataj. Kapitali fillestar i kesaj shoqerie eshte 100.000 leke. Kapitali fillestar eshte derdhur ne nje llogari rrjedhese ne Banken e Tiranës SA, gje qe vertetohet nga dokumenti i leshuar prej saj.  
Ne keto rrethana, ne mbeshtetje te Ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ligjit nr.7667, date 28.1.1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare"

**K E R K O J M E :**


Regjistrimin e shoqerise tregtare "ALFLEXIM" shpk ne Regjistrin Tregtar si person juridik.  
Bashkengjitur ju paraqesim Kontraten e Themelimit te shoqerise, Statutin, vertetimin e bankes per depozitim e kapitalit themeltar .

Tirane, me 13.10.1998

**PER SHOQERINE. "ALFLEXIM" SHPK  
ADMINISTRATORI  
FATOS AHMATAJ**

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE TIRANE  
NR. 3241 REP  
NR. 20911 KOL

*Handwritten signature of Fatos Ahmataj*  
**Fatos Ahmataj**




**V E R T E T I M**

Vertetohet firma e Fatos Ahmataj , i biri i Hakiut dhe Donikes, lindur e banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, paisur me pasaporte nr.0863354, i cili me cilesine e Administratorit te shoqerise se sapo krijuar "ALFLEXIM shpk, sot ne daten 10.10.1998 u paraqit personalisht perpara meje noteres Vjollca Meçaj ne studion time ne rrugen "Mine Peza" pall.1 dhe neneshkroi kerkesen drejtuar Gjykates se Rrethit Tirane per regjistrimin e shoqerise "ALFLEXIM" shpk, te perpiluar jashte kesaj zyre. Une noterja e gjej kete akt ne perputhje me ligjin 7638, date 19.11.1992 prandaj e vertetoj sipas ligjit.  
Tirane, me 13.10.1998

**NOTERE  
VJOLLOA MECAJ**

*Handwritten signature of Vjollca Meçaj*  
**Vjollca Meçaj**





## KONTRATE SHITJE

Sot me date 06.10.1999 para meje noteres, Gentiana Shkodra, u paraqiten personalisht palet dhe kerkuan hartimin e Kontrates se Shitjes me permbajtjen si me poshte:

### Palet e Kontrates:

**Shitesi:** Agron Bejtja, i biri i Eshrefit dhe Lejlase, lindur ne Tirane me 19.12.1956, banues ne Rrugen "Mihal Grameno" P.12, Sh.4 Ap.46, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, ortak i Shoqerise "ALFLEXIM" Shpk., i identifikuar nepermjet pasaportes Nr.1640826

**Bleresi:** Fatos Ahmataj, i biri i Hakiut dhe Donikes, lindur ne Tirane me 02.03.1950, banues ne Rrugen "Sami Frasheri" P.13/1, Sh.1, Ap.5, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, ortak i Shoqerise "ALFLEXIM" Shpk., i identifikuar nepermjet pasaportes Nr.0719973

### Objekti i Kontrates

Objekt i kesaj Kontrate eshte shitja nga ana e Shitesit dhe blerja nga ana e Bleresit te pjeses se kapitalit qe Shitesi zoteron ne Shoqerine "ALFLEXIM" Shpk, person juridik, regjistruar ne Gjykatën e Tiranës me Vendimin Nr.20194 dt. 26.10.1998.

### Kushtet e Kontrates

1.- Shitesi i shtet Bleresit pjesen e tije te kapitalit ne Shoqerine "ALFLEXIM" Shpk. qe ze 50% te te gjithe kapitalit te Shoqerise, shitje e miratuar nga Asambleja e Ortakeve me vendimin Nr.5, date 30.10.1999.

2.- Çmimi i shitjes eshte 136.000 USD, i ndare si me poshte:

a) Pjesa ne para 81.000 Usd  
b) Ne natyre (pajsje makineri) 55.000 Usd, sipas inventarit me poshte:

- Fotokopje Xerox 3060 me Nr. serial 110660697	1 cope
- Fotokopje Xerox 3030 me Nr. serial 110693535	1 cope
- Fotokopje AGFA X805 me Nr. serial 31290256	1 cope
- Fotokopje AGFA X820 me Nr. serial 20018912	1 cope
- Fotokopje AGFA X58	2 cope
- Fotokopje AGFA XC315	2 cope
- Fotokopje Lanier 7613	1 cope
- Fotokopje AGFA X6	1 cope
- Pajsje dhe orendi te ndryshme gjendje ne objekt.	

3.- Pagesa e çmimit te shitjes do te likujdohet nga Bleresi si me poshte:

- Ne momentin e nenshkrimit te Kontrates 60.000 Usd si dhe makinerite dhe paisjet.
- 21.000 Usd me keste mujore duke filluar nga Janari deri ne Dhjetor 2000.

4.- Me nenshkrimin e kesaj Kontrate Shitesi zhvishet nga çdo e drejte pronesie mbi Shoqerine dhe pronar i vetem i Shoqerise mbetet ortakut bleres Fatos Ahmataj.

Kjo Kontrate pasi u lexua nga palet dhe u gjet ne perputhje me vullnetin e tyre te lire e te plote, u firmos nga ata pa verejtje.

**Palet e Kontrates:**

**Shitesi**

Agron Bejta

*Agron Bejta*  
*Bejta*

**Bleresi**

Fatos Ahmataj

*Fatos Ahmataj*  
*Ahmataj*

*Police*

*J. Muharrem Shkodra*

20194/1

4238

3. A. Capo  
18.10.1998 fl.

## K E R K E S E

- Kërkues:** Fatos Ahmataj, i biri i Hakiut, i datëlindjes 1950, lindur dhe banues në Tiranë, administrator i shoqërisë "ALFLEXIM" sh.p.k., person juridik, regjistruar në regjistrin tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë me vendimin nr. 20194, datë 26.10.1998, me seli në Rr. "Myslym Shyri", P. 60/4, Tiranë.
- Objekti:** Regjistrim i ndryshimit të pronësisë në shoqërinë "ALFLEXIM" sh.p.k. në regjistrin tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë.
- Baza ligjore:** Neni 21 i ligjit nr. 7632, datë 4.11.1992 " Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të kodit tregtar".

### GJYKATES SE RRETHIT

TIRANE

Shoqëria "ALFLEXIM" sh.p.k është regjistruar në regjistrin tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë me vendimin nr. 20194, datë 26.10.1998. Ajo është në pronësi të Fatos Ahmatajt dhe Agron Bejtës, secili me 50% të kapitalit të shoqërisë.

Me kërkesë të ortakut Agron Bejtja, asambleja e ortakëve në përputhje me dispozitat e ligjit për shoqëritë tregtare ka miratuar shitjen e kuotave të pronësisë së ortakut Agron Bejtja dhe blerjen e tyre nga ortakut Fatos Ahmataj. Miratimi është bërë me vendimin nr. 5, datë 30.09.1999 të asamblesë së ortakëve.

Për këtë qëllim ortakët kanë lidhur përpara noterit kontratën për shitjen e kuotave të kapitalit, e cila mban nr. 1398 kol. dhe nr 237 prot, datë 06.10.1999. Me këtë kontratë ortakut Fatos Ahmataj bëhet zotëruar i 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë "ALFLEXIM" sh.p.k., pra ortak i vetëm i saj.

Për këtë arsye dhe për shkak të ndryshimit të raporteve të pronësisë brenda shoqërisë, i kërkojmë gjykatës së Rrethit Tiranë regjistrimin në regjistrin tregtar të këtij ndryshimi. Bashkëlidhur kërkesës ndodhen kopja e vendimit të regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar, vendimi i asamblesë së ortakëve nr. 5, datë 30.09.1999 për miratimin e shitjes së kuotave të kapitalit, si dhe kontrata e shitjes e lidhur midis ortakëve.

Në pritje të vendimit të gjykatës,

Me respekt

**Administratori**  
**Fatos Ahmataj**

Fatos Ahmataj  


Shoqeria "ALFLEXIM" Shpk  
Nr. 07 Prot.

### VENDIM Nr. 5

Asambleja e ortakeve te Shoqerise "ALFLEXIM" Shpk., e perbere prej ortakeve Fatos Ahmataj dhe Agron Bejtja u mbledh sot me date 30.09.1999 me kerkesen e administratorit te dates 23.09.1999. Ne mbledhje ku te dy ortaket ishin te pranishem, si mbajtes 100% te kapitalit te Shoqerise,

#### Konstatuan:

Se ortaku Agron Bejtja, zoteruesi i 50% te kuotave te kapitalit i ka ofruar pjesen e tije per shitje ortakut tjeter dhe se, ortaku Fatos Ahmataj eshte i gatshem qe te bleje kete pjese me çmimin dhe kushtet e permbajtura ne oferte.


Te dy ortaket, qe perfaqsojne 100% te kapitalit te Shoqerise, miratojne transferimin e pjeseve te kapitalit dhe,

#### Vendosen:


- 1.- Ortaku Agron Bejtja te shese pjesen e tije te kapitalit te Shoqerise per llogari te ortakut Fatos Ahmataj me çmimet dhe kushtet e percaktuara ne kontraten perkatese.
- 2.- Administratori i Shoqerise te ndjeke procedurat ligjore per reflektimin e ketij ndryshimi ne regjistrin tregtar.
- 3.- Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

#### Ortaket

Agron Bejtja



Fatos Ahmataj



"ALFLEXIM" sh.p.k  
Rr. "Myslym Shyri" 60/4  
Tel : 355 4 26 56 93  
Fax : 355 4 24 07 95  
E-mail: [alflexim@albaniaonline.net](mailto:alflexim@albaniaonline.net)  
Tirane

## V E N D I M

i ortakut te vetem

Nr.2, date, 20.09.2003

